

Desara Beqari Gjonej

mit Illustrationen von Leo Camaj

E treta, e vërteta! **Aller guten Dinge sind drei**

Zweisprachiges Lesebuch Albanisch-Deutsch für den
Erstsprachenunterricht/Muttersprachenunterricht mit Aufgaben in
albanischer Sprache für die 2.-4. Klasse Volksschule

ISBN 978-3-85253-723-8
SBNr. 210387

Vom Bundesministerium für Bildung, Wissenschaft und Forschung mit der Geschäftszahl
2021-0.694.012 vom 29.11.2021 für den Muttersprachlichen Unterricht für die 2.-4. Schulstufe an
Volksschulen geeignet erklärt.

© 2022 E. Weber Verlag GmbH, www.eweber.at
Druck: druck.at, Leobersdorf

Roza e Rozina

Sot fëmijët kanë orën e gjuhës shqipe.

Mësuesi u thotë që do të lozin lojën "Roza e Rozina". Fëmijët gëzohen, sepse ata e duan shumë këtë lojë. Të gjithë kapen dorë për dore dhe krijojnë kështu një rreth.

Duke ecur njëkohësisht në drejtim të akrepave të orës, ata e thonë vjershën ose e këndojnë atë:

Roza e Rozina
na sjellin trëndafila,
bashkë me zambakë
dhe me lule të tjera.
Sillu-sillu rrumbullak,
s'kemi ftohtë aspak.
Duke lujt' dhe kërcy',
Ulemi e thërrasim: "Byyy!"

Në fund, kur fëmijët thërrasin "Byyy!", ata ulen galiç dhe bëjnë kujdes që mos t'i lëshojnë duart.

Pastaj loja fillon nga e para. Kësaj here, ata ecin në drejtim të kundërt të akrepave të orës.

1. Shkruaji fjalët saktë.

- | | | |
|---------------------------------|--------|-------|
| 1. Loja quhet: Roza e ... | aiznRo | _____ |
| 2. S'kemi ftohtë ... | pkasa | _____ |
| 3. Roza e Rozina na sjellin... | ulel | _____ |
| 4. Fëmijët e duan shumë këtë... | loëj | _____ |

Rosa und Rosina

Heute haben die Kinder Albanischunterricht. Der Lehrer sagt ihnen, dass sie heute das Spiel „Rosa und Rosina“ spielen werden. Die Kinder freuen sich, denn sie lieben dieses Spiel. Alle halten sich an den Händen und bilden so einen Kreis.

Sie gehen im Uhrzeigersinn und sagen oder singen den Reim:

Rosa und Rosina
bringen uns Rosen,
samt Lilien und anderen Blumen.
Wir gehen im Kreis herum.
Uns wird es nicht kalt.
Spielend und tanzend
hocken wir uns und rufen: „Büh!“

Wenn die Kinder am Schluss in die Hocke gehen und „Büh!“ rufen, achten sie darauf, dass sie die Hände nicht loslassen. Danach beginnt das Spiel von Neuem. Diesmal gehen die Kinder gegen den Uhrzeigersinn.

2. Vendosi reshtat sipas rradhës së saktë.

LL		s'kemi ftohtë aspak.
U		Sillu-sillu rumbullak,
A		Duke lujt' dhe kërcy',
M		bashkë me zambakë
RR	1	Roza e Rozina
U		na sjellin trëndafila,
B		dhe me lule të tjera.
K		Ulemi e thërrasim: "Byyy!"

RR							
-----------	--	--	--	--	--	--	--





Loja e kungulleshës

Entela dhe Flamuri janë motër e vëlla. Ata janë me babin e tyre në makinë dhe po udhëtojnë drejt shtëpisë. Flamuri ankohet: "Uh, u mërzita!" I ati u premton fëmijëve: "Ja, edhe pak mbërrijmë në shtëpi. Ndërkohë mund të luani një lojë." Entela ka një ide: "Flamur, a luajmë lojën e kungulleshës?"

Vëllai është dakord. Atij i pëlqen shumë kjo lojë. Ata duhet të pyesin dhe të përgjigjen shpejt e shpejt, si dhe, nuk lejohet t'i përsërisin numrat që janë thënë tashmë një herë. Loja fillon.

Flamuri: "Kam një kungulleshë dhe e ndaj në tri pjesë."

Entela: "Pse për tri?"

Flamuri: "Po për sa?"

Entela: "Për pesë!"

Flamuri: "Pse për pesë?"

Entela: "Po për sa?"

Flamuri: "Për dhjetë!"

Entela: "Pse për dhjetë?"

Flamuri: "Po për sa?"

Entela: "Për dhjetë!"

Oh, jo! Entela u ngatërrua dhe përsëriti numrin dhjetë! Flamuri fiton lojën. Ai pyet: "Bëjmë edhe një lojë?" "Po", përgjigjet Entela, "por tani do të fitoj unë!"

3. Shkruaji fjalët saktë.

1.	Entela e Flamuri janë motër e ...	ëallv	
2.	Vajza quhet ...	laEnet	
3.	Djali quhet...	urFlma	
4.	Ata luajnë lojën e ...	lleshkunguës	
5.	Loja e kungulleshës luhet shpejt e	shpejt	

Das Zucchini-Spiel

Entela und Flamur sind Geschwister. Sie sitzen mit ihrem Vater im Auto und fahren nach Hause. Flamur jammert: „Mir ist langweilig!“ Der Vater verspricht den Kindern: „Wir sind gleich zu Hause. Inzwischen könnt ihr ein Spiel spielen.“ Entela hat eine Idee: „Flamur, spielen wir das Zucchini-Spiel?“

Ihr Bruder ist einverstanden. Er mag dieses Spiel sehr. Dabei sollen sie ganz schnell fragen und antworten. Sie dürfen die bereits erwähnten Zahlen nicht wiederholen. Das Spiel beginnt.

Flamur: „Ich habe einen Zucchini und teile ihn in drei Stücke.“

Entela: „Warum in drei?“

Flamur: „In wie viele sonst?“

Entela: „In fünf!“

Flamur: „Warum in fünf?“

Entela: „In wie viele sonst?“

Flamur: „In zehn!“

Entela: „Warum in zehn?“


Flamur: „In wie viele sonst?“


Entela: „In zehn!“


Oje! Entela irrte sich und wiederholte die Nummer zehn! Flamur gewinnt das Spiel. Er fragt: „Spielen wir noch eine Runde?“

„Ja“, antwortet Entela, „aber diesmal gewinne ich!“

4. Luajeni lojën me fruta dhe perime të tjera. Hiqi një vijë fjalëve të gabuara.







Disa gjëgjëza

Kur i zgjidh, rrinë.

Kur i lidh, ikin.

Çfarë janë?

Ikën duke qeshur dhe vjen duke qarë.

Çfarë është?

Bie në ujë e nuk laget.

bie në ferrë e nuk griset,

bie në gurë e nuk thyhet.

Çfarë është?



Rruqe-rruqe paparruqe,

gjysmë e bardhë, gjysmë e kuqe.

Çfarë është?

Rrumbullak-strumbullak,

ka shtatë vrima rreth e qark.

Çfarë është?

5. Mësojini gjëgjëzat përmendësh dhe pyesni prindërit tuaj.

A i dinë ata zgjidhjet e sakta?

Einige Rätsel

Löst man sie, bleiben sie stehen.

Bindet man sie zu, gehen sie.

Was ist das? (eine Paar Schuhe)



Er geht lachend und kommt weinend.

Was ist das? (ein leeres/nasses Wasserimer)



(Der Eimer ist „lachend“, wenn er leer ist, und „weinend“, wenn das Wasser tropft)

Sie fällt ins Wasser und wird nicht nass,

sie fällt auf Dornen und reißt nicht,

sie fällt auf Steine und bricht nicht.

Was ist es? (eine Sonne)



Es ist halb weiß, halb gelb

und nicht ganz rund

Was ist es? (ein Ei)



Es ist rund und hat sieben Löcher.

Was ist es? (ein Kopf)



Turrë apo jazë?

Miri dhe Mia e luajnë me dëshirë lojën "Turrë apo jazë?".

Së pari ata marrin në dorë një monedhë me vlerë 1 euro dhe e shikojnë atë me vëmendje. Në këtë lojë, pjesa e monedhës ku shihet një shqiponjë, quhet "turrë", dhe pjesa tjetër, ku shkruhet numri një, quhet "jazë".

Përpara se të fillojë loja, fëmijët caktojnë se cilën pjesë të monedhës do të zgjedhin: turrë apo jazë.

Mia vendos: "Turrë!". Miri thotë: "Jazë!"

Mia fillon lojën. Së pari ajo e vendos monedhën mbi gishtin tregues dhe atë të madh. Më pas me gishtin e madh e hedh monedhën në ajër. Tashmë ajo fluturon dhe sillet disa herë. Vajza bën kujdes që monedha të mos bjerë në tokë dhe e kap atë shpejt me dy duar. Tani duart me monedhën në to i shtrëngon fort dhe ashtu të mbyllura i shtrin mbi tryezë. Me kujdes e ngre dorën e sipërme. Të dy fëmijët shohin me kureshtje se cila anë e monedhës qëndron sipër - turra apo jaza?

Është pjesa e monedhës me numrin mbi të, pra "jaza". Kësaj here, lojën e fiton Miri. Më pas fëmijët ia nisin lojës nga fillimi.

6. Vendosi fjalitë në rradhën e duhur.

DH		I hap duart dhe shoh me kureshtje a është ...
E		E hedh monedhën në ajër dhe e kap me dy duar
O		Pjesa e parme me numër quhet "jazë".
M	1	Marr një monedhë dhe e shoh me vemendje.
N		Pjesa e pasme me shqiponjë quhet "turrë".
Ë		...turrë apo jazë.

Loja "Turrë apo jazë" luhet me

M					
----------	--	--	--	--	--

Kopf oder Zahl?

Miri und Mia spielen gerne das Spiel „Kopf oder Zahl?“. Als Erstes nehmen sie eine 1-Euro-Münze zur Hand und schauen sich diese genau an. In diesem Spiel heißt die Münzenseite, worauf ein Adler abgezeichnet ist, „Kopf“ und die andere, worauf die Eins steht, „Zahl“.

Bevor das Spiel beginnt, bestimmen die Kinder, für welche Münzenseite sie sich entscheiden: Kopf oder Zahl.

Mia entscheidet sich für „Kopf!“

Miri sagt: „Zahl!“



Mia beginnt. Zuerst legt sie die Münze auf ihren Zeigefinger und den Daumen. Danach wirft sie diese mit dem Daumen in die Luft. Nun fliegt die Münze und dreht sich dabei mehrmals. Das Mädchen achtet darauf, dass die Münze nicht auf den Boden fällt und fängt sie schnell mit beiden Händen auf. Da presst sie die Hände mit der Münze darin fest zusammen und legt sie geschlossen auf den Tisch. Vorsichtig hebt sie die oben liegende Hand. Beide Kinder schauen neugierig, welche Seite der Münze oben liegt – Kopf oder Zahl?



Es ist die Seite mit der Zahl darauf, also „Zahl“. Diesmal gewinnt Miri das Spiel. Danach beginnen die Kinder das Spiel von Neuem.

Achtung: Im Albanischen sind die Wörter „turrë“ und „jazë“ „Nonsense-Wörter“. Das heißt, sie bedeuten nicht wortwörtlich „Kopf“ und „Zahl“ – doch im Spiel selbst tragen sie diese Bedeutung.

7. Cilat fjalë nuk janë në tekst? Hiqi një vijë fjalëve të gabuara.

~~shkollë~~

turrë

shokë

monedhë

shi

jazë

fluturon

Hapa dollapa

Sot është një ditë me shi, por Mimoza, Dritani, Ermali dhe Jeta nuk mërzen. Ata luajnë në banesë "Hapa dollapa".

Mimoza është në lojë. Ajo i mbyll sytë dhe numëron deri në njëzet:

"Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë, katërmëdhjetë, pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë, tetëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë, njëzet!"

Më pas thërret:

"Hapa dollapa!

Kush është fshehur prapa?

Dil, se të kapa!"

Tani vajza i hap sytë dhe kërkon fëmijët që janë fshehur kudo nëpër banesë. Mimoza kërkon nën tryezë, nën shtrat, pas derës së kuzhinës, pas derës së dhomës së ndenjes. Tashmë i gjen dy fëmijë: Ermali është fshehur pas perdes, kurse Dritani është fshehur brenda në dollapin e rrobave.

Po Jeta, ku është fshehur? Mimoza vonon ta gjejë atë, por nuk dorëzohet dhe vazhdon ta kërkojë pas raftit të librave, në banjo dhe në kabinën e dushit. Më në fund e gjen edhe Jetën. Vajza ishte fshehur në shtrat nën batanije dhe kishte vënë përsipër disa lodra. "Një ide gjeniale, Jeta!", thërrasin fëmijët.

Mimoza i gjeti të gjithë fëmijët. Tani hyn Ermali në lojë.

Verstecken spielen

Heute ist ein regnerischer Tag, aber für Mimoza, Dritan, Ermal und Jeta wird es nicht langweilig. Sie spielen in der Wohnung Verstecken.

Mimoza ist dran. Sie schließt die Augen und zählt bis zwanzig:

„Eins, zwei, drei, vier, fünf, sechs, sieben, acht, neun, zehn, elf, zwölf, dreizehn, vierzehn, fünfzehn, sechzehn, siebzehn, achtzehn, neunzehn, zwanzig!“

Anschließend ruft sie:

„Alles muss versteckt sein!
Ich komme!“

Nun macht das Mädchen die Augen auf und sucht nach den Kindern, die überall in der Wohnung versteckt sind.

Mimoza sucht unter dem Tisch, unter dem Bett, hinter der Küchentür, hinter der Wohnzimmertür. Schon findet sie zwei Kinder: Ermal hatte sich hinter dem Vorhang versteckt und Dritan im Kleiderschrank.

Und Jeta? Wo hat sie sich versteckt? Mimoza braucht lange, um sie zu finden, doch sie gibt nicht auf und sucht weiter nach ihr. Das Mädchen sucht hinter dem Regal, im Badezimmer und in der Duschkabine. Endlich findet sie auch Jeta. Das Mädchen hatte sich im Bett unter der Decke versteckt und hatte einige Spielsachen darüber verstreut. „Eine geniale Idee, Jeta!“, rufen die Kinder.

Mimoza fand bereits alle Kinder. Nun ist Ermal an der Reihe.